	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F-009/30
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i detyrave të punës

Data e hyrjes në fuqi: 02.04.2019

Pozita:

Edukatore për grupin parashkollor



Përmbledhje

Edukatorja për grupin parashkollor është përgjegjëse për zhvillimin e aktiviteteve mësimore për grupmoshat 4-5 dhe 5-6 vjeç sipas planprogramit dhe nevojave të projektit “Rritja e përfshirjes në edukimin parashkollor dhe fillor” të përkrahur nga REF, i cili zbatohet në dy shkolla të Komunës së Prizrenit.

Kualifikimet


- Diploma e Fakulteti të Edukimit për edukimin parashkollor ose e barasvlershme;
- Njohuri e punës me kompjuter;
- Njohuri në fushën e arsimit;
- Përvojë pune me fëmijë;

Aftësitë tjera

- Aftësi të mira të mësimdhënies;
- Aftësi të mira të komunikimit me fëmijë;
- Aftësi për të punuar nën stres

Detyrat

- Përgatit planet javore bazuar në metodologjinë Hap pas Hapi;
- Zbaton sesionet me fëmijë të planifikuara paraprakisht;
- Bashkëpunon me mësimdhënësit tjerë, posaçërisht me edukatoren e klasës parafillore;
- Dorëzon planet javore tek drejtori i shkollës dhe menaxheri përgjegjës në KEC;
- Vëzhgon dhe vlerëson në formë sistematike secilin fëmijë;
- Sigurohet që hapësira / klasa ofron mjedis të sigurt dhe është rregulluar ashtu që plotëson nevojat e fëmijëve;
- Sigurohet që mjetet të cilat përdoren në klasë janë të përshtatshme për fëmijët parashkollorë;

	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F-009/30
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

- Mban kontakt me prindërit e fëmijëve kryesisht të përqendruar tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe njofton ata për rëndësinë e zhvillimit në fëmijërinë e hershme;
- Mban takime të rregullta me prindërit sipas planit të përcaktuar paraprakisht;
- Lehtëson dhe përmirëson komunikimin në mes të familjes dhe institucionit;
- Përbush detyra të tjera që ndërlidhen me implementimin e projektit dhe që kërkohen nga Menaxheri i Projektit.

Lidhjet dhe raportimet

Edukatorja i raporton menaxherit të projektit, Petrit Tahiri.

Orët e punës

Edukatorja i realizon ditët e punës në bazë të orarit të përcaktuar nga KEC dhe në marrëveshje me menaxherin përgjegjës të KEC. Lokacioni i punës është qyteti i Prizrenit.

Kompensimi

Kompensimi i Edukatores bëhet konform kontratës së punës.